



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

**RAPORT VJETOR I 2025 PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK, TË
REALIZUAR NGA MINISTRIA E MBROJTJES**

1. Përmbledhja ekzekutive

Gjatë vitit 2025, Ministria e Mbrojtjes ka vijuar zbatimin e procesit të konsultimit publik, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Procesi është zhvilluar në mënyrë të rregullt dhe të plotë, duke garantuar respektimin e detyrimeve ligjore në të gjitha fazat e tij. Në këtë kuadër, për vitin 2025 janë publikuar për konsultim publik 7 (shtatë) akte, përmes platformës RENJKP, nga të cilat janë miratuar 4 (katër) prej tyre. Gjithashtu, janë konsultuar të dy projektligjet e planifikuara në PVKP 2025, por nuk u miratuan në 2025.

Të dhënat e përftuara nga Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK) tregojnë se aktet e publikuara kanë ngjallur interes të konsiderueshëm, me gjithsej 5,016 vizitorë të regjistruar gjatë periudhës së konsultimit. Krahës konsultimit elektronik, janë organizuar edhe tryeza konsultimi, të cilat kanë shërbyer si mekanizma shtesë për përfshirjen e aktorëve të interesit. Këto aktivitete kanë kontribuar në rritjen e cilësisë së dialogut dhe në sigurimin e inputeve nga grupe të ndryshme të interesuara.

Përcaktimi i akteve që i janë nënshtruar konsultimit publik është bërë në përputhje me objektin dhe fushën e zbatimit të ligjit nr. 146/2014. Në bazë të nenit 1 të këtij ligji, procesi i konsultimit publikohet për projektligje dhe projekt-dokumente strategjike në nivel kombëtar dhe vendor, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë te publiku dhe palët e interesuara.

Në të njëjtën kohë, janë respektuar përjashtimet e parashikuara në nenin 4 të ligjit nr. 146/2014, i cili përcakton kategoritë e projekt akteve që nuk i nënshtrohen konsultimit publik, përfshirë çështjet që lidhen me sigurinë kombëtare dhe sekretin shtetëror, marrëveshjet ndërkombëtare, aktet normative të Këshillit të Ministrave me fuqinë e ligjit, emergjencat civile, si dhe raste të tjera të parashikuara shprehimisht nga legjislacioni në fuqi. Për rrjedhojë, aktet e Ministrisë së Mbrojtjes që bien në këto kategori, janë përjashtuar nga procesi i konsultimit publik.

2. Analiza e konsultimeve të kryera


2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

Numri i akteve të Ministrisë së Mbrojtjes që i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik gjatë vitit 2025, është 7 (shtatë) akte:

1. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9210, datë 23.3.2004, “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Strategjia Kombëtare për Mospërhapjen e Armëve të Dëmtimit në Masë dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj.
3. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 46/2018 “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, i ndryshuar.
4. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”.
5. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 173/2014 “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
6. Projektligji “Për importin, eksportin dhe transitin e armëve të zjarrit, komponentëve kryesorë dhe municioneve”.
7. Projektvendim "Për miratimin e listave të mallrave, që mund të përdoren ose nuk kanë përdorim tjetër përveç qëllimit të dënimit me vdekje, torturës ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, të cilat janë objekt i kontrollit shtetëror të transferimeve ndërkombëtare".


2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

Numri total i akteve të miratuara për vitin 2025 është 49, nga të cilat 3 prej tyre janë të klasifikuara “Konfidencial”. Aktet e miratuara janë 47 VKM dhe 3 projektligje.



2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?⁴

4 (katër) akte i janë nënshtruar dhe kanë përfunduar procesin e konsultimit publik. Në lidhje me pjesën tjetër të akteve të cilat janë miratuara, konkretisht 42 prej tyre, nuk kanë qenë objekt i konsultimit publik në përputhje me parashikimet e ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.



2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

Janë konsultuar 3 (tre) projektligje me raport VNR, konkretisht:


1. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 46/2018 “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, i ndryshuar.
2. Projektligji “Për rezervat materiale të shtetit”,
3. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Në lidhje me projekt aktet e tjera të miratuara gjatë kësaj periudhe, 44 prej tyre nuk janë objekt i procesit të vlerësimit të ndikimit, sipas përcaktimeve të pikës 45, në Kreun VI të VKM nr. 584, datë 28.8.2003 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar, kanë qenë objekt i procesit të vlerësimit të ndikimit, sipas përcaktimeve të pikës 45/1, shkronja a) në Kreun VI të VKM nr. 584, datë 28.8.2003 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar, që përcakton se përjashtohen nga detyrimi i kryerjes së vlerësimit të ndikimit:

a) Projekt akte që trajtojnë çështje, të cilat lidhen me informacionin e klasifikuar shtetëror, çështje të sigurisë kombëtare dhe organizatat ndërkombëtare të sigurisë.

2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

Për 30 aktet e parashikuara në Programin Analitik gjatë vitit 2025, për 26 prej tyre janë përdorur kriteret e përjashtimit nga konsultimi publik sipas përcaktimeve të ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, pasi janë në listën shteruese për të cilën është i detyruar konsultimi publik.



2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

Aktet e konsultuara janë 5 (pesë) projektligje dhe 2 (dy) projektvendime.

2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Në raport me vitin paraardhës, gjatë këtij viti vërehet një ecuri më pozitive e procesit të konsultimit publik. Numri i akteve të përfshira në konsultim ka qenë më i lartë dhe procesi është zhvilluar në mënyrë më të balancuar, duke kombinuar përdorimin e Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK) me forma të drejtpërdrejta të komunikimit me grupet e interesit.

Gjatë vitit raportues është rritur frekuenca e organizimit të takimeve konsultative, të cilat janë zhvilluar si në fazën e hershme të përgatitjes së akteve, ashtu edhe gjatë periudhës së konsultimit publik. Ky zhvillim është favorizuar nga krijimi i kushteve më të përshtatshme për takime fizike, si dhe nga përdorimi i platformave online, të cilat kanë ndihmuar në zgjerimin e pjesëmarrjes së palëve të interesuara.

Në tërësi, këto elemente tregojnë një përmirësim të mënyrës së organizimit dhe zbatimit të procesit të konsultimit publik, krahasuar me vitin e kaluar.

2.2. Metodatat e konsultimit

2.2.1. Cilat ishin metodatat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)

Metodat e konsultimit të projekt akteve të miratuara ishin si më poshtë:

- Regjistri elektronik për njoftim dhe konsultim publik;
- Nëpërmjet e mail-it;
- Nëpërmjet sistemit e-Akte, ku janë dërguar për mendim në ministritë e linjës;
- Nëpërmjet zhvillimit të takimeve publike.

2.2.2. Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Metoda e cila gjeneroi më shumë komente ishte nëpërmjet publikimit në regjistrin elektronik të konsultimit publik, duke gjeneruar 2 (dy) komente.

2.2.3. A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Po, Ministria e Mbrojtjes organizoi takime paraprake për 4 (katër) aktet e konsultuara, me grupet e interesit, konkretisht strukturat dhe institucionet në varësi të tij për të diskutuar të gjitha projekt aktet përpara se të fillonte me hartimin e draftit të tyre.

2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1. Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?

Konsultimi në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike për 4 aktet e konsultuara gjatë vitit 2025 u realizua në përputhje me ligjin nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, përkatësisht me nenin 15 të tij.

2.3.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Procesi i konsultimit publik për aktet e planifikuara gjatë vitit 2025, i zhvilluar përmes Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK), është realizuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, në veçanti me dispozitat e nenit 15 të këtij ligji. Për secilin akt, periudha e konsultimit publik ka qenë 20 ditë pune, e llogaritur nga data e publikimit në regjistrin elektronik.

Ndërkohë, duke marrë parasysh të gjitha format e përdorura të konsultimit, përfshirë edhe fazën paraprake të konsultimit, rezulton se kohëzgjatja mesatare e procesit konsultativ për projekt aktet ka qenë rreth 3 muaj, duke garantuar kohë të mjaftueshme për informim dhe kontribut nga palët e interesuara.

2.3.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Gjatë këtij viti kemi konstatuar një përmirësim të mënyrës së organizimit dhe ndjekjes së procesit të konsultimit publik, krahasuar me vitet e mëparshme. Ky përmirësim lidhet kryesisht me forcimin e rolit të koordinatorit të konsultimit publik në Ministrinë e Mbrojtjes, i cili ka pasur një angazhim më aktiv në të gjitha fazat e procesit.

Një ndikim të drejtpërdrejtë në këtë drejtim kanë pasur edhe trajnimet e zhvilluara, të cilat kanë kontribuar në rritjen e kapaciteteve profesionale, në kuptimin më të qartë të rëndësisë së konsultimit publik dhe në administrimin më efektiv të tij. Paralelisht, është përmirësuar bashkëpunimi me strukturat teknike përgjegjëse për hartimin e akteve, duke lehtësuar identifikimin dhe përfshirjen e grupeve të interesit që kanë dhënë kontribut në proces.

2.4. Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

Kryesisht, në grupet e punës për hartimin e akteve ka marrë pjesë personeli i Ministrisë së Mbrojtjes. Pavarësisht kësaj, për projekt aktet që kanë impakt të drejtpërdrejtë tek grupet e interesit jashtë Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, janë organizuar takime publike.

2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)

Aktet të cilat i janë nënshtruar konsultimit publik, janë diskutuar nëpërmjet mbledhjeve të zhvilluara me anëtarët e grupit të punës, me strukturat në varësi të MM dhe SHPFA.

Ekspertë të jashtëm nuk ka patur.

2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultimet e hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?

Nga konsultimi përmes Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet, ka patur 38 pjesëmarrës, kontribuues.

2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?

Aktet i janë nënshtruar konsultimit publik nëpërmjet mbledhjeve të zhvilluara me anëtarët e grupit të punës, me pjesëmarrjen e SHPFA dhe strukturave në varësi të tyre. Aktet i janë nënshtruar konsultimit publik nëpërmjet mbledhjeve të zhvilluara me anëtarët e grupit të punës, me pjesëmarrjen e AKSHE. Gjithashtu gjatë fazës paraprake pati sugjerime dhe kontribut edhe nga ushtarakë pjesëmarrës në operacione kombëtare dhe ndërkombëtare dhe stafe akademike të institucioneve arsimore dhe studimore të FARSH.

2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Në krahasim me vitet e mëparshme, konstatohet një tendencë pozitive në zhvillimin e procesit të konsultimit publik. Ky përmirësim është reflektuar kryesisht në mënyrën e organizimit dhe koordinimit të procesit brenda Ministrisë së Mbrojtjes.

Gjatë vitit raportues, roli i koordinatorit të konsultimit publik ka qenë më i konsoliduar, duke ndikuar në ndjekjen më sistematike të procedurave dhe në sigurimin e bashkërendimit më të mirë me strukturat teknike që hartojnë aktet. Trajnimet e zhvilluara kanë kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e konsultimit publik, si dhe në përmirësimin e kapaciteteve për menaxhimin efektiv të këtij procesi.

Si rezultat, është lehtësuar edhe identifikimi dhe përfshirja e grupeve të interesit, të cilat kanë pasur një rol më aktiv në dhënien e mendimeve dhe sugjerimeve gjatë fazave të hartimit dhe finalizimit të akteve.

2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1. Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?

Nga konsultimi përmes Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet ka pasur 45 komente, mesatarisht 11 komente për çdo projekt.

2.5.2. Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

Nga konsultimi përmes Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet, ka patur 45 komente për aktet e konsultuara dhe miratuara sipas kësaj metode, nga të cilat, 31 janë pranuar plotësisht, 6 janë pranuar pjesërisht dhe 8 janë refuzuar.

2.5.3. Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

Krahasuar me vitet e kaluara, ku takimet publike ishin metoda që gjeneronte numrin më të madh të komenteve, kjo periudhë nuk ishte në një gjendje të kënaqshme, duke qenë se përfshirja e publikut nuk ishte në nivel ndikues.

2.5.4. Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?

Raporti i VNR nuk është përditësuar në përfundim të procesit të konsultimit pasi reagimet e mbledhura nuk ndryshojnë implikimet e politikës së krijuar.

2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.1. Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?

Gjatë vitit 2025, Ministria e Mbrojtjes publikoi në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik raportet e konsultimit publik për 4 (katër) aktet e miratuara.

2.6.2 Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?

Nuk ka raporte konsultimi publik të pa publikuara për vitin 2025.

2.7 Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksën e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

Sa i përket këtyre projekt akteve, bëjmë me dije se është respektuar me rigorozitet procedura dhe kërkesat e ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”:

- Projekt aktet janë publikuar në RENJK;
- është dhënë informacion i mjaftueshëm;
- janë ruajtur prova të mjaftueshme për reagimet e tyre;
- në draftin e ri pasqyrohet një shkallë e mirë e reflektimit të reagimit të palëve të interesuara lidhur me konsultimin e gjerë me grupet e interesit;
- është respektuar afati 20 ditor.

Për këtë arsye, Ministria e Mbrojtjes është vetë vlerësuar me pikët maksimale (8) për 4 (katër) aktet, për të cilët procesi i konsultimit publik ka përfunduar.

3.Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen *(Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)*

Sfidat kryesore të evidentuara në zhvillimin e procesit të konsultimit publik lidhen kryesisht me nivelin e përfshirjes së publikut. Pavarësisht përpjekjeve dhe mundësive të ofruara nga Ministria e Mbrojtjes, ende nuk është konsoliduar plotësisht një kulturë aktive e pjesëmarrjes në proceset e hartimit të politikave. Në këtë kuadër, pjesëmarrja e publikut përmes Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK) mbetet e kufizuar, veçanërisht në aspektin e paraqitjes së komenteve, rekomandimeve apo qëndrimeve mbi përmbajtjen e projekt akteve.

Në periudhën në vijim, me synimin për të rritur efektivitetin e konsultimit publik, parashikohet që procesi të orientohet më shumë drejt një informimi dhe komunikimi më dinamik me publikun. Ky qasje pritet të kontribuojë në rritjen e njohurive mbi procesin e konsultimit, në përdorimin më të gjerë të metodave të konsultimit dhe, rrjedhimisht, në shtimin e pjesëmarrjes së publikut në diskutimin e projekt akteve që hartohen.